



In medias res

FAZAT NËPËR TË CILAT KALOJNË NDRYSHIMET NË ARSIM (3)

“E ndërruat udhëheqësin, e keni ndërruar organizatën.
Ndryshimi do të thotë zhvillim” J. Maxwell

Pas incizimit të gjendjes në arsim, zhvillohet një debat i fuqishëm me ekspertë, me nxënës, mësues, ekonomiste, juristë, politikologë, me qytetarë, me gazetarë etj. Ky debat i fuqishëm ka dy qëllime:

a. të merren inputet plotësuese relevante për gjendjen në arsim, inputet të cilat nuk janë përfshirë apo nuk janë identifikuar gjatë skanimit - vlerësimit të gjendje së shëndetit të sistemit të arsimit, si dhe

b. të stimulohet një presion i opinionit publik mbi hartuesit e politikave, në mënyrë që ata të jenë përgjegjës dhe të vetëdijesohen se do t'i nënshtrohen llogaridhënies.

Teoria e ndryshimit ka dëshmuar së në të gjitha vendet ku nuk ka ekzistuar një “presion” i publikut mbi hartuesit e politikave zhvillimore, atje nuk ka pasur përgjegjësi për veprime, andaj edhe ndryshimet kanë dështuar, apo janë shndërruar në ndryshime retrograde, që në vend se të nxjerrin sistemin nga kriza e kanë thelluar atë edhe me shumë.


Në këtë fazë, roli i medieve është jashtëzakonisht i madh. Ky rol është aq i madh sa sipas bindjes time, atje ku mjetet e informacionit për çfarëdo arsye nuk kanë qenë pjesë aktive në ndryshimet në arsim, ato nuk kanë arritur të jetësohen.

Vlerësimet janë se mjetet e informacionit në Kosovë nuk e kanë lozur këtë rol andaj edhe nismat “reformuese” në Kosovë nuk kanë pasur sukses. Mjetet e informacionit mund të ndihmojnë që liderët të cilët kanë frikë nga ndryshimet të ndryshojnë qëndrimet ndaj ndryshimeve në arsim.

Në Teorinë e ndryshimeve janë evidencuar 11 pika të dobëta të liderëve, të cilat vështirësojnë ndryshimet në arsim. Këto pika janë:

1. Pak i kuptojnë njerëzit
2. U mungon imagjinata- kreativiteti
3. Kanë probleme personale
4. Ndihen të sigurt dhe të vetëkënaqur
5. Nuk janë të organizuar
6. Kanë sulme hidhërimi
7. Nuk dëshirojnë të rrezikojnë
8. Janë të pasigurt dhe kanë qëndrim mbrojtës
9. Mbeten të pandryshueshëm
10. Nuk kanë shpirt për punë ekipore
11. Luftojnë kundër ndryshimeve

Mjetet e informacionit duhet të ndihmojnë që lakorja që paraqet në grafikun vijues të ndryshojë duke rritur përqindja e njerëzve që e pranojnë ndryshimin.



Legjenda:

Inov. - Inovacion
Sh.p.n.-Shpejtë e pranojnë ndryshimin
PV- Me pak vonesë e pranojnë ndryshimin
VN- Me vonesë
HF – Hamenden deri ne fund

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Gjatë muajit qershor është bërë certifikimi i 290 mësimeve, të cilët u trajnuan në kuadër të programit të MKLSH. Trajnimi i këtyre mësimeve u financua nga KEC. Të certifikuarit ishin mësime të regjionit të Prishtinës (2 grupe), të Gjakovës (2 grupe), të Mitrovicës, të Pejës, të Ferizajt dhe të Gjilanit. Në mesin e të certifikuarve ishin dhe 36 mësime të komunës së Podujevës, të cilët u trajnuan me vetëfinancim. KEC e mbështeti trajnimin e këtij grupi me ofrimin e udhëzuesve 1-8 të programit të MKLSH-së për secilin pjesëmarrës. Po ashtu gjatë qershorit u certifikuan dhe 2 mësime për nivelin e dytë të certifikimit.

■ KEC dhe DKA e Obiliqit kanë filluar një bashkëpunim për të trajnuar në kuadër të MKLSH 40 mësime të komunës së Obiliqit. Trajnimi i këtyre mësimeve do të fillojë më 4-5 korrik.

Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

■ Është hartuar Doracaku për krijimin mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla, është krijuar Komiteti Rajonal për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në Gjakovë. Me 16 qershor është mbajtur. Punëtorja njëditore në të cilën janë marr inpute për krijimin dhe pilotimin e punës së Komiteteve shkollorë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, Komiteteve komunale dhe të Komiteti rajonal. Gjatë

muaji shtator dhe fillimit të muajit korrik janë duhur vazhduar takimet nëpër rajone dhe komuna ku bëhet monitorimi i aktiviteteve me qëllim këshillimi dhe instruksioni.



Hap pas Hapi

■ Gjatë këtij muaji është punuar në finalizimin e Instrumentit të monitorimit të shkollave që zbatojnë metodologjinë Hap pas Hapi. Pasi që të finalizohet ky dokument pastaj do të organizohet trajnimi me drejtorë të shkollave për mënyrën e shfrytëzimit të këtij instrumenti, respektivisht për mënyrën e zhvillimit të monitorimit.

KOSOVISION Contest

■ Aktivitetet e këtij projekti kanë përfunduar. Gjatë këtij muaji janë bërë vlerësimet e stafit lokal të projektit e po ashtu edhe vlerësimi i tërë projektit. Rezultatet e Vlerësimit kanë qenë shumë të larta kështu që ky projekt do të vazhdojë me realizim të vitit të dytë në shtator të këtij viti.

Tanimë kanë filluar përgatitjet për vitin e dytë.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të këtij projekti të financuar nga Komisioni Evropian,

aktivitetet janë duke u zhvilluar sipas dinamikës së projektit. Këtë muaj janë zgjedhur edhe 30 shkollat e grupit të kontrollit të cilat do të jenë pjesë e projektit tonë. Po ashtu janë përcaktuar edhe 60 monitorët e brendshëm të shkollave të cilët do të fillojnë me punën e tyre në shtator.

■ Punëtorja njëditore për finalizimin e hartimit të kornizës monitoruese, e cila ishte e paraparë të mbahet gjatë muajit qershor, është shtyer për fund të muajit gusht me qëllim që të mblidhen edhe më shumë indikacione dhe të zhvillohet një kornizë e mirë monitorimi.

■ Po ashtu në kuadër të këtij projekti kemi filluar mbledhja e materialeve bazë që do të shfrytëzohen për hartimin e manualit të trajnimit për fëmijë. Ky manual është menduar të përmbaj një sërë ligjërata dhe ushtrime për të drejtat e fëmijës dhe avokimin. Manuali është i paraparë të publikohet në muajin shtator.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

Gjatë muajit qershor në kuadër të projektit “Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim” janë zhvilluar këto aktivitete:

- Secili shtet partner e ka caktuar koordinatorin e vet të projektit.
- Është mbajtur takim i parë virtual i Bordit Drejtues të Projektit. Në takim morën pjesë koordinatorët e shteteve partnere (mungoi koordinatorja nga Shqipëria) dhe përfaqësuesja e Institutit për Shoqëri të Hapur. U diskutua për shumë çështje me rëndësi dhe u

caktuan datat për realizimin e disa aktiviteteve.

- Çdo shtet e ka caktuar hulumtuesin e vet që do të merr pjesë në grupin punues për hulumtimet nacionale
- Është emëruar personi që do të merret me zhvillimin e uebfaqes www.apreme.net
- Në fillim të korrikut 4 përfaqësues të organizatave partnere do të marrin pjesë në konferencën “Konsolidimi i partneriteteve në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike për ngritjen e të drejtave të pakicave në regjion” të organizuar nga Komisioni Evropian në Bruksel.

Prevention on Peer Violence

■ Shkollat pjesëmarrëse në këtë projekt, kanë përfunduar me sukses trajnimet e tyre me nxënës. Të gjitha shkollat (10 shkolla) kanë mbajtur nga tri punëtori me nxënësit e tyre. Gjithsej 6856 nxënës kanë përfituar nga këto trajnime.

■ Që nga muaji i ardhshëm e deri në shtator do të bëhen vetëm përgatitjet për fazën e dytë të trajnimit të trajnerëve. Do të përgatiten materialet dhe do të bëhen edhe përkthimet e materialeve të cilat do të përdoren në trajnim.

Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës

Ka filluar zbatimi i projektit “Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës”. Për zbatimin e projektit janë zgjedhur 6 shkolla, tri prej të cilave janë nga viset urbane dhe tri nga ato rurale. Në mënyrë që të avancohet bashkëpunimi me prindër në këto shkolla, u mbajt një

punëtori dy-ditore ku morën pjesë nga dy përfaqësues prej secilës shkollë. Njëri nga përfaqësuesit ishte nga personeli i shkollës (drejtori apo ndonjë mësimdhënës) ndërsa tjetri nga prindërit. Gjatë punëtorisë u diskutuan mënyrat e ndryshme të bashkëpunimit. Në fund u vendos që të përqendrohemi në takimet individuale me prindër, ku edhe u hartua drafti i parë i procedurës së bashkëpunimit me anë të takimeve individuale.

Access Microscholarship Program

Në fillim të qershorit përfunduan orët e gjuhës angleze në kuadër të programit ACCESS Microscholarship për të tre grupet, dy në Prishtinë dhe një në Prizren.

Pas përfundimit të orëve u organizua një aktivitet social ku morën pjesë fëmijët e të tre grupeve. Aktiviteti social u organizua në BoBowling ku fëmijët patën rastin të shoqërohen në mes vete dhe të luajnë me birila. Në fund të gjithë u ndanë të kënaqur.

Përgatiti: Petrit Tahiri